



Stadi: 01/11/2016

Aplikim për vizë me qëllim lidhje martese dhe qëndrim të vazhdueshëm

Lutemi të lexoni me kujdes këtë fletë-informacioni dhe formularin e aplikimit dhënë bashkëngjitur. Duke qenë i/e përgatitur mirë ju mund të ndikoni pozitivisht dhe të shkurtoni procedurën përkatëse.

Aplikimet e plotësuar në mënyrë të mangët apo dokumentacioni i paplotë mund të çojnë në refuzimin e aplikimit me pasojë rezervimin e një date të re aplikimi.

Në rastin e aplikimit për vizë Ambasada duhet të përfshijë në procedurë zyrën përkatëse për të huajt në Gjermani. Për këtë arsye procedurat zgjasin zakonisht 8 deri në 10 javë, në raste të veçanta edhe më gjatë. Ndaj lutemi për mirëkuptimin Tuaj për faktin që brenda 8 javëve të para, prej ditës së aplikimit, nuk mund t'u japim përgjigje pyetjeve lidhur me stadin aktual të procedurës.

Të gjitha dokumentat që tërhiqen pranë Ambasadës (fletët e informacionit, formularët e aplikimit) janë gratis. Të gjitha informacionet rreth procedurës së aplikimit i gjeni në faqen e internetit të Ambasadës www.tirana.diplo.de

Gjatë procedurave të aplikimit Ambasada mund të kërkojë në raste të veçanta dokumenta të tjera shtesë, që nuk përmenden në këtë fletë informacioni.

| I gjithë dokumentacioni duhet të paraqitet në origjinal! | | |
|---|---|---|
| 1. | Pashaporta e udhëtimit <i>+ 2 kopje (të gjitha faqet e rëndësishme)</i> | Me të paktën dy faqe bosh. Lutemi mbani në konsideratë, që afati i vlefshmërisë së pashaportës duhet të jetë tre muaj më i gjatë se kohëzgjatja e vizës. <ul style="list-style-type: none">Fotokopjoni ju lutem fletën e plastifikuar me të dhënat personale dhe sigurohuni që të ketë të paktën edhe dy faqe të tjera bosh |
| 2. | 2x formularë aplikimi për vizë kombëtare | Aplikim për lëshimin e lejes së qëndrimit në gjermanisht ose anglisht, të plotësuar në mënyrë plotësisht të lexueshme, të nënshkruara personalisht si dhe dy deklaratat të nënshkruara |

| | | | |
|----|--|--|--|
| | | personalisht sipas §§ 53 dhe 54 të Ligjit për të Huajt. <u>Jo</u> aplikim për vizë Schengen! | |
| 3. | 3x fotografi | 3 fotografi identike biometrike për pashaportë, jo më të vjetra se 6 muaj, me sfond të bardhë, madhësia 45x35 mm. → Lutemi që në secilin prej dy formularëve të aplikimit të ngjisni nga një fotografi, ndërsa fotografinë e tretë silleni me vete si element të veçantë. | |
| 4. | Tarifa | Tarifat dhe detyrimet duhet të paguhen kesh në monedhën shqiptare LEK . Tarifa është 60 Euro përlllogaritur me kursin aktual të këmbimit, plus një tarifë e përgjithshme prej 500 lekësh. Aplikimet për bashkim familjar me shtetas të BE-së/Komunitetit Ekonomik Evropian janë të përjashtuara nga tarifat. | |
| 5. | Regjistrim i lidhjes martesore pranë një zyre gjermane të gjendjes civile + 2 kopje Ose Vërtetim një zyre gjermane të gjendjes civile për plotësimin e të gjitha kritereve për një lidhje martesore + 2 kopje | <i>Ju lutem mbani në konsideratë që gjithsesi vërtetimi i regjistrimit të lidhjes martesore pranë një zyre gjermane të gjendjes civile duhet të paraqitet maksimumi deri në lëshimin e vizës! E njëjta gjë vlen edhe për përcaktimin e datës konkrete të lidhjes martesore!</i> Certifikatat që nuk janë në gjuhën gjermane dhe nuk lëshohen sipas një formulari ndërkombëtar duhet të përkthehen dhe të legalizohen. Përkthimi duhet të jetë i noterizuar. Duhet të dorëzohen nga dy kopje për certifikatën dhe përkthimin. Certifikatat shqiptare me formular ndërkombëtar NUK kanë nevojë të përkthehen, por duhet të legalizohen. Duhet dorëzuar dy kopje të certifikatës. | |
| 6. | Pashaportë / kartë identiteti / leje qëndrimi e të fejuarit/ës në Gjermani | Duhet të paraqiten dy kopje të kartës së identitetit ose pashaportës të të fejuarit /ës. Nëse i fejuari / e fejuara nuk ka nënshtetësinë gjermane, atëherë duhet të paraqiten dy kopje të lejes së qëndrimit. | |
| 7. | Dëshmi për vendbanimin nga Gjermania + 2 kopje | Vërtetim për vendbanimin e partnerit në Gjermani lëshuar përmes zyrës së regjistrimit (jo më herët se para 6 muajsh) | |
| 8. | Deklaratë me shkrim e të fejuarit / ës që banon në Gjermani sipas §§ 66-68 të Ligjit për të Huajt + 2 kopje | I fejuari / e fejuara duhet të deklarojë me shkrim se merr përsipër kostot që mund të lindin deri në momentin e lidhjes martesore në përputhje me §§ 66 – 68 të Ligjit për të Huajt. <i>I fejuari/ e fejuara duhet të informohen në kohën e duhur pranë autoriteteve lokale për të huajt,</i> | |

| | | | |
|----|---|--|--|
| | | <i>nëse në kaudër të shqyrtimit të aplikimit do të duhet edhe një deklaratë formale garancie.</i> | |
| 9. | Dëshmi për njohuritë e gjuhës gjermane <i>+ 2 kopje</i> | <p>Njohuri të thjeshta mbi gjuhën gjermane mund të dëshmohen parimisht nga një certifikatë aktuale gjuhe në nivelin „Deutsch – A1“, e cila në Shqipëri mund të merret pranë Qendrës Goethe (www.goethe.al). Informacione më të hollësishme për këtë mund të gjeni në fletën e informacionit „Njohuritë e gjermanishtes në rastin e tërheqjes së bashkëshortit/es“.</p> <p><i>Dëshmia e njohurive të thjeshta të gjuhës gjermane nuk do të ishte e nevojshme nëse e fejuara / i fejuari juaj:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Është zotërues i Kartës Blu të BE-së apo i një leje-qëndrimi si i shumëkualifikuar (§19 Ligji për të Huajt), studiuës (§20 Ligji për të Huajt), themelues i një firme (§21 i Ligjit për të Huajt) ose ka statusin e refugjatit (§§ 25 Kreu 1 ose Kreu 2, respektivisht, 26 Kreu 3 i Ligjit për të huajt).</i> • <i>Në kuadër të aplikimit mund të konstatohet dukshëm zotërimi i njohurive gjuhësore (si p.sh. një diplomë studimi në gjuhën gjermane). Në këto raste mund të hiqet dorë nga paraqitja e një dëshmie gjuhësore. Lutemi të mbahet në konsideratë, se niveli i zotërimit të njohurive gjuhësore do të verifikohet ditën e aplikimit. Në rast dyshimi gjatë procedurës mund të kërkohet paraqitja e një certifikate gjuhësore.</i> • <i>Nga detyrimi i paraqitjes së një dëshmie gjuhësore mund të përjashtohen edhe ato raste, kur konstatohet një shkallë e ulët e nevojës për tu integruar, e cila supozohet përgjithësisht në rastet kur i fejuari / e fejuara zotëron një diplomë universitare/ të shkollës së lartë profesionale apo një kualifikim të caktuar profesional, dhe që - nisur edhe nga niveli i njohurive gjuhësore- mendohet që do të mund të fillojë punë në Gjermani brenda një periudhe relativisht të shkurtër në kërkim të vendit të punës dhe se do të mund të integrohet pa asistencën shtetërore në jetën ekonomike, shoqërore dhe kulturore në Gjermani. Të tre këto kushte paraprake</i> | |

| | | | |
|--|--|---|--|
| | | <p><i>duhet të përmbushen njëherazi (kualifikimi, pritshmëri pozitive lidhur me punësimin, pritshmëri pozitive lidhur me integrimin). Në përgjithësi paraqitja vetëm e një diplome universitare nuk mjafton për të dalë në përcaktimin e një shkalle të ulët të nevojës për tu integruar.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Për pamundësinë e përvetësimit të njohurive gjuhësore mund të jepen argumente të një rasti specifikisht të vështirë. Për këtë do të duhej të paraqitej një shkresë shoqëruese dhe eventualisht dëshmitë përkatëse. Fakte të tilla si p.sh. kurset e gjuhës ofrohen në qendra të largëta apo se për frekuentimin e tyre do të duhej një kujdestare fëmijësh, nuk do të vlenin si argumenta për një rast specifikisht të vështirë.</i> • <i>Nëse pretendohet se përvetësimi i njohurive gjuhësore është i pamundur për arsye mjekësore, atëherë duhet të paraqiten vërtetime / diagnozat përkatëse mjekësore, secili/a prej tyre në dy kopje. Analfabetizmi apo një moshë e avancuar nuk përbëjnë gjendje sëmundjeje apo handicap-i në kuptimin e një situatë përjashtimore. Mbani në konsideratë që gjatë shqyrtimit të aplikimit tuaj mund t'ju kërkohet të paraqiteni te mjeku lokal i Ambasadës. Informacione të mëtejshme rreth vizitës dhe caktimit të një orari do t'ju jepen në moëmentin e duhur. Vizita mjekësore mbart kostos përkatëse.</i> • <i>Në rastin e bashkimit me një bashkëshort/e apo partner/e të ardhshëm/shme gjerman/e: mund të hiqet dorë nga detyrimi i paraqitjes së dëshmisë së gjuhës, nëse megjithë përpjekjet e vazhdueshme përvetësimi i gjuhës brenda një viti ka qenë gjithsesi i pasuksesshëm. Por përpjekjet e vazhdueshme duhet të jenë të konstatueshme përmes dëshmive përkatëse, psh. listës së kursantëve, prej nga të rezultojë pjesëmarrja e rregullt në kurs, përshkrim i hollësishëm i përpjekjeve për të mësuar etj., pra tentativat e vazhdueshme për të mësuar gjuhën duhet të paraqiten në mënyrë bindëse dhe të</i> | |
|--|--|---|--|

| | | | |
|-----|---|---|--|
| | | <i>kuptueshme. Dëshmitë për një apo disa provime gjuhësore të dhëna në mënyrë të përsëritur pa patur sukses nuk do të ishin të mjaftueshme.</i> | |
| 10. | Siguracion shëndeti në rast udhëtimi <i>+ 2 kopje</i> | Për të paktën javët e para të qëndrimit të planifikuar në Gjermani është e nevojshme të lidhet një siguracion shëndeti (nëse për periudhën vijuese është lidhur apo do të lidhet një i tillë). | |
| 11. | Partner pa shtetësi gjermane? <i>+ 2 kopje</i> | Nëse i fejuari / e fejuara juaj në Gjermani nuk ka shtetësinë gjermane ai/ ajo duhet të bashkangjisë: <ul style="list-style-type: none"> • Një vërtetim për financa të mjaftueshme për jetesën e tij dhe të partnerit/es (deklaratë formale obliguese ose vërtetimet e pagës për 3 muajt e fundit ose vërtetim aktual i zyrës së tatimeve), dhe • Një kopje të leje-qëndrimit, e cila të bëjë të qartë se mbi ç'bazë është lëshuar. | |

Klauzolë e përjashtimit nga përgjegjësia:

Të gjitha informacionet e mësipërme përcillen pa garancinë se janë të sakta apo të plota. Ato bazohen në stadin informativ të Ambasadës në momentin e hartimit të tyre.